



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić – Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës të mbajtur me dt.17.04.2026, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Albanë Shillova Shalaku (LVV), Arbenita Pllana (LVV), Bardhyl Mjekiqi (LVV), Burim Ismaili (LVV), Fitim Grajçevci (LVV), Fjolla Nasufi (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Mervete Shala (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Labinot Mirena (LDK) dhe Dorentina Mustafa (AAK).

**Të pranishmit tjerë:** Kryetari i Komunës, Halil Thaqi, Berat Gashi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, zyrtarët komunal dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesuesi, cili pasi konstatoi se ka kuorum, filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Plani i rrjetit të linjave dhe subvencionimi i transportit publik për udhëtarët në territorin e Komunës së Obiliqit

**Kryesuesi** – Ju të gjithë e keni pranuar kërkesën dhe materialin e përcjellë për këtë mbledhje dhe ndjej obligim të japë një shpjegim, jo për të tjerët por për qytetarët e Obiliqit. Seanca është thirrë në bazë të rregullave dhe procedurave ligjore dhe çdo gjë tjetër që flitet dhe përflitet nuk qëndron. Në këtë seancë i kemi të pranishëm 11 anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe e kemi një kërkimfalje nga z.Abdyrrahman Krasniqi, i cili nuk ka mund të marrë pjesë për arsye se është jashtë vendit, ndërsa asambleistët tjerë të LDK-së, bashkë me 2 asambleistët e listës serbe, nuk e kanë parë të arsyeshme të marrin pjesë në këtë seancë shumë të rëndësishme për qytetarët e Obiliqit.

I nderuar Kryetar, sa herë që ju shprehni kërkesa që janë në të mirë të qytetarëve, unë si kryesues dhe përfaqësuesit e vërtetë të qytetarëve edhe nëse, është e nevojshme paradite dhe pasdite duhet me marrë pjesë në këto kërkesa, në këto projekte që janë shumë të rëndësishme për qytetarët e Obiliqit. Sa për informacionin e juaj nganjëherë disa anëtarë të Kuvendeve Komunale, nuk marrin pjesë në seanca të jashtëzakonshme sepse seancat e jashtëzakonshme nuk paguhen ndërkaq, interesat e qytetarëve janë shumë më të mëdha dhe është dashur të marrin pjesë sepse ky është vendi për të diskutuar. Ne pajtohemi se nganjëherë kemi mundësi me pasë kundërshtime, sugjerime dhe pyetje, por pikërisht këtu është vendi për t'i bërë ato dhe për të marrë përgjegje.

Pastaj, kryesuesi i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 11 vota për.

**Kryesuesi** – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme dhe për një shpjegim më detal rreth kësaj çështjeje, fjalën ia dha drejtorit të DSHPE-së.

**Valon Svirca** – Duke pasë parasysh kërkesën e qytetarëve që të kenë transport në çdo fshat, që njëkohësisht ka qenë edhe zotim i qeverisjes tonë ne kemi formuar 2 komisione; njëri për hartimin e itinerareve dhe linjave, ndërsa tjetri për subvencionimin e linjave. Gjithashtu, në ditët në vijim ju njoftoj se do të merret vendim edhe për linjën në Hade, si i themi ne Hadja e vjetër, ku të gjitha lagjet janë të përfshira në itinerarin e ri të linjave. Këto, vendime nuk janë vetëm planifikim, por zgjidhje konkrete për qytetarët tonë, kështu që ju ftoj ta mbështetni.

**Labinot Mirena** – E falënderoj drejtorin për shpjegimin e dhënë sepse unë jam nga fshati Hade, dhe e kam parë se Hadja e vjetër nuk është e përfshirë në transport. Unë e përkrahu këtë projekt dhe e kam ngritë zërin edhe në mandatet e kaluara për një transport të të gjitha fshatrave që ka qenë i domosdodhëm, por që nuk është bërë asnjëherë. Unë jam pro që Hadja e vjetër të mos anashkalohet sepse Hadja e vjetër është anashkaluar nga të gjitha qeveritë për shkak të shpronësimeve. Mendoj se kishte me qenë mirë ne si Komunë me i përfshi në transport sepse janë pak banorë dikund 11 ose 12 familje dhe është mirë që ato familje ta kenë transportin në të ardhmen.

**Kryetari** – Sot është një ditë e veçantë për qytetarët e Komunës së Obiliqit, sepse para vetes kemi një plan të transportit publik, që ne si Komunë kemi vendos të subvencionojmë për kilometër linjat e transportit publik. Është e rëndësishë së veçantë për neve si qeverisje që çdo qytetar i Komunës së Obiliqit ta ketë të mundshëm transportin publik. Ne jemi dëshmitarët të kohës se tani që 26 vite pasluftë shumë fshatra nuk janë përfshirë në transportin publik. Arsyeja e operatorëve ekonomik ka qenë sepse nuk kanë pasë llogari që të përfshijnë transportin publik në shumë pjesë të Komunës së Obiliqit. Prandaj, ne kemi vendos që duke subvencionuar për kilometër të bëjmë gjithë përfshirjen e transportit publik. Unë iu falënderoj shumë asambleistë të dashur që iu keni përgjegjë ftesës time për këtë seancë të jashtëzakonshme, që për nga rëndësia mendoj se është shumë e rëndësishme për vetë interesin e qytetarëve. E kemi parasysh se në këtë transport publik më së paku përfshihemi ne zyrtarët e Komunës, edhe ata që ishin para neve edhe ne sot, por këtu transporti publik iu shërben më shumë nxënësve, studentëve, dhe pensionerëve, që janë shtresat që më së shumti kanë nevojë për ndihmën dhe shërbimet tona. Unë iu bëjë thirrje edhe operatorëve ekonomik që do të jenë përfitues të këtyre linjave dhe iu bëjë thirrje që të jenë të vëmendshëm, të mos e shkelin ligjin dhe të mos e shkelin Rregulloren që e përcakton Komuna, sepse do të jemi të pakompromis dhe nuk do të tolerojmë një gjë që ka ndodhë për 26 vjet radhazi në transportin publik. Të gjithë jemi dëshmitarë se çfarë ka ndodhë. Unë iu bëjë thirrje ata që pranojnë këto linja, atyre që iu pranohet licenca për këto linja duhet të jenë të përgjegjshëm në përpikmëri. Përndryshe, organet tona komunale do të jenë në krye të detyrës.

**Kryesuesi** – Atëherë, ju ftoj që ta bëjmë miratimin e këtij plani me shtojcën të cilën drejtori e ceku lidhur me fshatin Hade.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 11 vota për morën Vendim për miratimin e rrjetit të linjave urbane periferike dhe numri i orareve në to.

**Kryesuesi** – Meqë, nuk kemi diskutime tjera atëherë, e mbylli seancën.

Mbledhja përfundoi në ora 11:23

Zyrtare e lartë për punë të KK

  
Azize Zeneli





REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić – Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës të mbajtur me dt.17.04.2026, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Albanë Shillova Shalaku (LVV), Arbenita Pllana (LVV), Bardhyl Mjekiqi (LVV), Burim Ismaili (LVV), Fitim Grajçevci (LVV), Fjolla Nasufi (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Mervete Shala (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Labinot Mirena (LDK) dhe Dorentina Mustafa (AAK).

**Të pranishmit tjerë:** Kryetari i Komunës, Halil Thaqi, Berat Gashi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, zyrtarët komunal dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesuesi, cili pasi konstatoi se ka kuorum, filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Plani i rrjetit të linjave dhe subvencionimi i transportit publik për udhëtarët në territorin e Komunës së Obiliqit

**Kryesuesi** – Ju të gjithë e keni pranuar kërkesën dhe materialin e përcjellë për këtë mbledhje dhe ndjej obligim të japë një shpjegim, jo për të tjerët por për qytetarët e Obiliqit. Seanca është thirrë në bazë të rregullave dhe procedurave ligjore dhe çdo gjë tjetër që flitet dhe përflitet nuk qëndron. Në këtë seancë i kemi të pranishëm 11 anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe e kemi një kërkimfalje nga z.Abdyrrahman Krasniqi, i cili nuk ka mund të marrë pjesë për arsye se është jashtë vendit, ndërsa asambleistët tjerë të LDK-së, bashkë me 2 asambleistët e listës serbe, nuk e kanë parë të arsyeshme të marrin pjesë në këtë seancë shumë të rëndësishme për qytetarët e Obiliqit.

I nderuar Kryetar, sa herë që ju shprehni kërkesa që janë në të mirë të qytetarëve, unë si kryesues dhe përfaqësuesit e vërtetë të qytetarëve edhe nëse, është e nevojshme paradite dhe pasdite duhet me marrë pjesë në këto kërkesa, në këto projekte që janë shumë të rëndësishme për qytetarët e Obiliqit. Sa për informacionin e juaj nganjëherë disa anëtarë të Kuvendeve Komunale, nuk marrin pjesë në seanca të jashtëzakonshme sepse seancat e jashtëzakonshme nuk paguhen ndërkaq, interesat e qytetarëve janë shumë më të mëdha dhe është dashur të marrin pjesë sepse ky është vendi për të diskutuar. Ne pajtohemi se nganjëherë kemi mundësi me pasë kundërshtime, sugjerime dhe pyetje, por pikërisht këtu është vendi për t'i bërë ato dhe për të marrë përgjegje.

Pastaj, kryesuesi i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 11 vota për.

**Kryesuesi** – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme dhe për një shpjegim më detal rreth kësaj çështjeje, fjalën ia dha drejtorit të DSHPE-së.

**Valon Svirca** – Duke pasë parasysh kërkesën e qytetarëve që të kenë transport në çdo fshat, që njëkohësisht ka qenë edhe zotim i qeverisjes tonë ne kemi formuar 2 komisione; njëri për hartimin e itinerareve dhe linjave, ndërsa tjetri për subvencionimin e linjave. Gjithashtu, në ditët në vijim ju njoftoj se do të merret vendim edhe për linjën në Hade, si i themi ne Hadja e vjetër, ku të gjitha lagjet janë të përfshira në itinerarin e ri të linjave. Këto, vendime nuk janë vetëm planifikim, por zgjidhje konkrete për qytetarët tonë, kështu që ju ftoj ta mbështetni.

**Labinot Mirena** – E falënderoj drejtorin për shpjegimin e dhënë sepse unë jam nga fshati Hade, dhe e kam parë se Hadja e vjetër nuk është e përfshirë në transport. Unë e përkrahu këtë projekt dhe e kam ngritë zërin edhe në mandatet e kaluara për një transport të të gjitha fshatrave që ka qenë i domosdodhëm, por që nuk është bërë asnjëherë. Unë jam pro që Hadja e vjetër të mos anashkalohej sepse Hadja e vjetër është anashkaluar nga të gjitha qeveritë për shkak të shpronësimeve. Mendoj se kishte me qenë mirë ne si Komunë me i përfshi në transport sepse janë pak banorë dikund 11 ose 12 familje dhe është mirë që ato familje ta kenë transportin në të ardhmen.

**Kryetari** – Sot është një ditë e veçantë për qytetarët e Komunës së Obiliqit, sepse para vetes kemi një plan të transportit publik, që ne si Komunë kemi vendos ti subvencionojmë për kilometër linjat e transportit publik. Është e rëndësishë së veçantë për neve si qeverisje që çdo qytetar i Komunës së Obiliqit ta ketë të mundshëm transportin publik. Ne jemi dëshmitarët të kohës se tani që 26 vite pasluftë shumë fshatra nuk janë përfshirë në transportin publik. Arsyeja e operatorëve ekonomik ka qenë sepse nuk kanë pasë llogari që të përfshijnë transportin publik në shumë pjesë të Komunës së Obiliqit. Prandaj, ne kemi vendos që duke subvencionuar për kilometër të bëjmë gjithë përfshirjen e transportit publik. Unë iu falënderoj shumë asambleistë të dashur që iu keni përgjegjë ftesës time për këtë seancë të jashtëzakonshme, që për nga rëndësia mendoj se është shumë e rëndësishme për vetë interesin e qytetarëve. E kemi parasysh se në këtë transport publik më së paku përfshihemi ne zyrtarët e Komunës, edhe ata që ishin para neve edhe ne sot, por këtu transporti publik iu shërben më shumë nxënësve, studentëve, dhe pensionerëve, që janë shtresat që më së shumti kanë nevojë për ndihmën dhe shërbimet tona. Unë iu bëjë thirrje edhe operatorëve ekonomik që do të jenë përfitues të këtyre linjave dhe iu bëjë thirrje që të jenë të vëmendshëm, të mos e shkelin ligjin dhe të mos e shkelin Rregulloren që e përcakton Komuna, sepse do të jemi të pakompromis dhe nuk do të tolerojmë një gjë që ka ndodhë për 26 vjet radhazi në transportin publik. Të gjithë jemi dëshmitarë se çfarë ka ndodhë. Unë iu bëjë thirrje ata që pranojnë këto linja, atyre që iu pranohet licenca për këto linja duhet të jenë të përgjegjshëm në përpikmëri. Përndryshe, organet tona komunale do të jenë në krye të detyrës.

**Kryesuesi** – Atëherë, ju ftoj që ta bëjmë miratimin e këtij plani me shtojcën të cilën drejtori e ceku lidhur me fshatin Hade.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 11 vota për morën Vendim për miratimin e rrjetit të linjave urbane periferike dhe numri i orareve në to.

**Kryesuesi** – Meqë, nuk kemi diskutime tjera atëherë, e mbylli seancën.

Mbledhja përfundoi në ora 11:23'

Zyrtare e lartë për punë të KK

  
Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

  
Sami Ahmeti